



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 16.04.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-23138-13/2 të miratuar me dt: 25.03.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së- dega në Gjakovë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të akademive përkujtimore dhe shpenzimeve operative të kësaj organizate, me dt: 16.04.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së- dega në Gjakovë, e evidentuar me nr. 01-400-9923 e dt: 03.02.2015, për mbështetje financiare të kësaj organizate për mbarëvajtjen punëve dhe për mbulimin e shpenzimeve të akademive përkujtimore për periodën një vjeçare, duke e mbështetur me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 3,050.00€.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3,050.00€, nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së- dega në Gjakovë, nr. 1402000001758448, Banka Ekonomike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Z. Sadri Hoxha, kryetar i OVLUÇK-së- dega në Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila